

ALBANA MEMA**PROFILI POLITIK I AHMET ZOGUT NË VITET 1921-1924
NË OPTIKËN E DIPLOMATËVE ANGLEZË**

Ngritja e institucioneve shtetërore dhe roli i tyre në mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe të konsolidimit të shtetit ishte arritja më e madhe e periudhës së pas Luftës së Parë Botërore. Por, konceptet dhe qëndrimet e krerëve politikë shqiptarë, në raport me shtetin dhe përgjegjshmëria e tyre kundrejt institucioneve shtetërore kishin defekte të dukshme.

Elita politike shqiptare në vitet 1919-1920 zhvilloi një fushatë të gjatë për të thirrur një kuvend kombëtar, i cili do të ishte shprehje e vullnetit të popullit shqiptar. Ndërmarrja kurajoze e Ahmet Zogut në këtë rast edhe roli që pati në Kongresin e Lushnjës, i siguroi atij një emër të mirë dhe prestigj në shoqërinë shqiptare. Ky prestigj, i gërshetuar me zgjuarsinë dhe energjinë e tij, do ta bënin atë faktor të rëndësishëm të politikës shqiptare në periudhën që po trajtojmë.

Gjatë vitit 1920, A. Zogu ishte ministër i Brendshëm në qeverinë e dalë nga Kongresi i Lushnjës, ku spikati me energjinë dhe efektivitetin e tij për vendosjen e rendit në Shqipëri në atë periudhë tepër të vështirë të ndërtimit të shtetit kombëtar. Dokumentet britanike heshtin për këtë fakt tashmë të gjithëpranuar, për shkak të mungesës së një përfaqësie diplomatike aktive që t'i analizonte zhvillimet politike të kësaj kohe në Shqipëri.

Përfaqësia britanike filloi të funksiononte efektivisht në Shqipëri në vitin 1922 nga ku vijnë edhe vlerësimet e para të saj për situatën në Shqipëri. Spikat një vlerësim interesant pozitiv i përfaqësuesit britanik, Harry Eyres, lidhur me zgjedhjet e para politike në Shqipëri. Një vit pas ballafaqimit të parë elektoral, përfaqësuesi britanik, Eyres, i bënte këtë përshkrim sintetik procesit zgjedhor të vitit 1921: “Duke pasur parasysh, se këto ishin zgjedhjet e para politike në Shqipëri, ata u zhvilluan me më

pak influencë (ndërhyrje politike) dhe me më tepër paanësi sesa ishte pritur”.¹

Një gjykim përgjithësisht pozitiv jepte përfaqësuesi britanik edhe mbi performancën e Parlamentit të parë Shqiptar gjatë vitit 1921. H. Eyres shkruante: “Dhoma e Deputetëve nuk është cilësuar për ndonjë rekord në miratimin e legjislacionit gjatë këtij viti. Por ka zhvilluar diskutime politike, për të cilat të gjithë shqiptarët janë të interesuar... Diskutimet janë zhvilluar me dinjitet dhe rregull dhe sjellja e deputetëve vlerësohet pozitivisht në raport me sjelljen dhe debatet në Parlamentet e vendeve fqinje.”²

Një analizë interesante i bënte misioni britanik edhe organizatës “Krahu Kombëtar” e cila ishte shtylla dhe forca e “Partisë Popullore”. Vlen të theksohet se kjo analizë bëhej në një moment kritik, pikërisht disa ditë pas grushtit të shtetit që rezultoi me rrëzimin e qeverisë së Pandeli Evangjelit në dhjetor 1921, i cili më pas dështoi dhe përfundoi me një fitore të “Partisë Popullore”. Diplomati britanik H. Smith, nuk e paraqiste këtë organizatë me një origjinë të hershme, por si të formuar pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1921. Kjo mendoj se dëshmon një njohje të pakët të tij rreth kësaj organizate. E rëndësishme është se ai i jepte Zogut, një rol parësor në formimin e kësaj organizate që edhe Smith, si kundërshtarët e saj politikë, e quante “Partia sekrete” ose (“Klika”). Ai informonte Sekretarin e Shtetit Curzon se “menjëherë pas mbledhjes së Parlamentit, ndërsa në hapje ishte një anëtar i fuqishëm i “Partisë Popullore”, Zogu formoi atë që këtu njihet si “Klikë””. Në fakt ky ishte hapi final i bashkimit të Zogut me “Krahun Kombëtar” ose me “Klikën” e cila ekzistonte edhe më parë. Vlerësimet e britanikëve për karakterin e kësaj organizate duket se ishin qysh në fillim realiste. Ajo portretizohej si një organizatë sekrete nacionaliste por edhe me disa tipare negative. Ky vlerësim do të mbetej konstant nga diplomatët britanikë gjatë gjithë periudhës që pasoi. Ajo cilësohej si një shoqëri

¹ *The National Archives*, London (më tej: TNA), në *Arkivin e Institutit të Historisë*, Public Record Office (më tej: PRO), Foreign Office (më tej: FO) 371/7332, f. 384-394. Raport vjetor për vitin 1921, H.C.A. Eyres, për Marquess Curzon of Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.

² TNA, PRO, FO 371/7332, f. 384-394. Raport vjetor i H.C.A. Eyres për situatën në Shqipëri gjatë vitit 1921 dërguar Marquess Curzon of Kedleston, Durrës, 1 maj 1922.

sekrete që krahasohej me Komitetin Xhonturk “Bashkim dhe Përparim”.³ H. Smith, në atë kohë, rendiste disa tipare negative të “Klikës”, si përpjekjet për të ndërhyrë në administratën e vendit, duke bërë rekrutime politike; tendencën për të bërë arrestime të motivuara politikisht dhe; ndërhyrjet për të shtrirë influencën e saj politike në ushtri. Smith kishte mendimin se “prania e tre zyrtarëve ushtarakë të rëndësishëm në “Klikë”, ishte tregues që ushtria ishte e përzier me politikën”. Ai shtonte se, “çdo veprim i “Klikës” synonte marrjen e pushtetit (dhe pasurisë) për anëtarët e saj, dhe prej saj nuk konsiderohej i paligjshëm asnjë mjet për të realizuar këtë qëllim”.⁴

Misioni britanik në Shqipëri analizoi një ngjarje të rëndësishme në zhvillimet politike të vitit 1921, krijimin e një koalicioni dypartiak në parlament që u quajt “Bashkimi i Shenjtë” dhe të qeverisë së tij të kryesuar nga Pandeli Evangjeli, e cila u miratua në Parlament. Në raportet e tij, misioni britanik i atribuonte një rol A. Zogut në krijimin e “Bashkimit të Shenjtë”. Në një raport të detajuar të Heathcote Smith, drejtuar Lordit Curzon nën titullin, “Pamja sipërfaqësore e partive” thuhej: “Grupet parlamentare në Tiranë, të zgjedhura në qershor 1921, u etiketuan si Progresive, Popullore dhe Grupi Katolik. Përveç këtyre, ishte Fan Noli si i pavarur dhe Hasan Prishtina me disa deputetë të Drinit, si irredentistë... Të krishterët, duke e parë pafuqinë e tyre kundrejt myslimanëve, e shtuan fushatën kundër bejlerëve. Ahmet Beu, si person i mprehtë që është, përfitoi nga kjo lëvizje për t’u bashkuar me “Bashkimin e Shenjtë”, i cili u krijua për t’i dhënë fund pushtetit të bejlerëve, edhe pse ai përfaqësonte tipin më ekstrem të bejlerëve që duheshin shtypur.”⁵

Ky raport interesant i përfaqësuesve britanikë në Shqipëri, të cilët i analizonin me kujdes dhe thellësi zhvillimet politike në vend, na jep një pjesë të tablosë se çfarë metamorfoze politike kishte ndodhur në Parlamentin Shqiptar gjatë rigrupimit politik të partive që formuan “Bashkimin e Shenjtë”. Kështu, ndonëse “Partia Përparimtare” deri në këtë kohë, kishte pasur një dominim fare të lehtë e të paqëndrueshëm në

³ TNA, PRO. FO 371/7330, f. 581-586. Telegram i Heathcote Smith për Curzon, 18 janar 1922.

⁴ *Po aty.*

⁵ *Po aty.*

parlament, kryeministër i qeverisë së “Bashkimit të Shenjtë” u zgjodh Pandeli Evangjeli, anëtar i “Partisë Popullore”.

Kjo analizë që bëhej disa muaj më vonë, në një kohë kur kishin precipituar shumë ngjarje, pas përmbysjes me grusht shteti të qeverisë së Pandeli Evangjelit, H. Smith bënte një analizë mbi mënyrën se si kishte ardhur në fuqi P. Evangjeli. Në një raport të detajuar, ai shkruante: “Ardhja në fuqi e “Partisë Popullore” në tetor, me kryeministër Pandeli Evangjelin, e cila nga pamja e jashtme ishte normale, në realitet fshihte një krizë tashmë të lindur. Falë mbështetjes së Ahmet Zogut, “Bashkimi i Shenjtë” u mbivotua në krahasim me qeverinë “Bejlerë” të Ilias Bej Vrionit. Historia e brendshme e ngjarjeve të fundit ka të bëjë me përpjekjen e Ahmet Zogut për të kapur frenat e qeverisë. Megjithatë, ai vuri re, që partitë opozitare, Aqif Pasha, Hasan Beu dhe të tjerët ishin tepër të vështirë për t’u mposhtur dhe zgjidhja u gjet me kompromisin e krijimit të kabinetit të të dobët dhe të ndershmit Evangjel”. Pra, Smith ia atribuonte këtë lëvizje politike A. Zogut, dhe e shihte krijimin e kabinetit si një *modus-vivendi* për të gjetur një balancë midis tij dhe kundërshtarëve politikë, Aqif Pashë Elbasani dhe Hasan Bej Prishtina.⁶

Por, roli që Smith i jepte Zogut në krijimin e “Bashkimit të Shenjtë” është vënë në dyshim nga burime të tjera, për shembull nga kujtimet e Sejfi Vllamasit dhe nga dokumentacioni diplomatik italian. Gjithashtu, duhet theksuar se Smith analizonte me mprehtësi qëllimin real të krijimit të “Bashkimit të Shenjtë” i cili ishte largimi nga pushteti i bejlerëve, ndonëse atëherë kjo lëvizje politike u trumbetua me të madhe si një bashkim i dy partive për të përballuar ndërhyrjen jugosllave që po shfaqej rrezikshëm përmes rebelimit të Markagjonit në Mirditë.

Destabilizimi i vendit, gjatë dhjetorit të vitit 1921 që kulmoi me grushtin e shtetit dhe shtypjen e tij pa gjakderdhje, duket se tronditi besimin e vakët që kishin pasur më parë përfaqësuesit britanikë, për mundësinë e funksionimit të një sistemi parlamentar në Shqipëri. Në një raport të titulluar “Imagjinata e qeverisjes parlamentare”, H. Smith i shkruante kështu Sekretarit të Jashtëm: “Mendoj se nuk ekzagjeroj po të them që të gjithë deputetët janë caktuar nga lart, votuesit në të dy

⁶ TNA, PRO. FO 371/7330, f. 581-586. Telegram i Heathcote Smith për Curzon mbi situatën politike në vend, 18 janar 1922.

kategoritë ndjekin verbërisht urdhrat e marra... Demokracia e Shqipëri është duke u ngushtuar dhe përqendrohet në Tiranë”.⁷

Pas dështimit të grushtit të shtetit në dhjetor 1921, Smith analizoi me kujdes edhe situatën e krijuar dhe masat që mori shumica parlamentare. Interesant është të nënvizohet fakti se, ai parashikonte konflikte të reja pas anulimit të mandateve të deputetëve të Drinit, si dhe kritikonte masat antiligjore për shkarkimin e regjentëve që kishin drejtuar grushtin e shtetit.⁸ Smith vendoste në qendër të konfliktit “Klikën” me grupet e tjera jashtë saj dhe parashikonte që konflikti midis tyre do të vijonte. “Ngjarjet e fundit, nënvizonte ai, kanë provuar se, çfarëdo organizatash sekrete nën pushtetin e Hasan Beut (Prishtinës) ose të një lideri tjetër, nëse ndodh diçka e tillë, janë për momentin në kundërshtim me “Klikën””.⁹

Nga gjithë këto zhvillime dramatike, Smith përcaktonte me saktësi dhe mprehtësi edhe ato që ai i quante, “pengesat në rritjen e Shqipërisë.” Ai theksonte: “Si përfundim, mund të thuhet se, mosmarrëveshjet e shumta në Shqipëri lindin nga nevoja që sjell loja në një *qeverisje parlamentare të trilluar*... Shqipëria, si një e tërë, nuk është akoma gati të trajtojë organizmin delikat të demokracisë kushtetuese. Një makineri e komplikuar në duart e njerëzve primitivë është e rrezikshme.”¹⁰ Në përfundim të raportit, Smith konkludonte duke sugjeruar një sistem autokratik.¹¹

Një muaj më vonë H. Smith, përsëriste shqetësimin për rrezikun e trazirave të tjera në të ardhmen dhe nënvizonte në këtë rast, domosdoshmërinë e thirrjes urgjente të Asamblesë Kushtetuese si dhe rreziqet që vinin nga shtyrja e saj. Ai informonte Lordin Curzon, se kabineti i zgjedhur më 25 dhjetor 1921 dhe i drejtuar nga Xhafer Ypi, ishte i vendosur të mos zhvillonte zgjedhje për Asamblenë Kushtetuese, derisa të përcaktoheshin kufijtë. Për pasojë, çështja e fuqisë sovrane në të ardhmen do të mbetej pezull.

Linja e dytë e stabilizimit të shtetit, nënvizonte Smith, ishte krijimi i një autoriteti të fortë, me të cilin ai nënkuptonte, vendosjen e një

⁷ *Po aty.*

⁸ *Po aty.*

⁹ TNA, PRO. FO 371/7330, f. 581-586. Telegram i Heathcote Smith për Curzon, 18 janar 1922.

¹⁰ *Po aty.*

¹¹ *Po aty.*

monarku me pushtet të gjerë. “Ndërmjet të gjithë shqiptarëve, shkruante ai, është kuptuar se, që në këtë vend të mbizotërojë paqja e brendshme, nevojitet një autoritet i fortë dhe i respektueshëm, i cili duhet të vendoset ose të pranohet vullnetarisht nga vendi. Vonesat e mëtejshme në zgjidhjen e kësaj çështjeje fundamentale, shihen si vazhdim i një periudhe pasigurie dhe trazirash”.¹²

Një rrezik tjetër, që ai shihte në horizont, ishin masat e forta ligjore që mund të merreshin ndaj organizatorëve të grushtit të shtetit të dhjetorit 1921. Smith shkruante: “Por, përsëri, në qoftë se kabineti i Hasan Prishtinës ndeshet me qortime nga Gjykata e Lartë, e cila ka fuqi mbi jetën dhe vdekjen, problemet mund të vazhdojnë”. Gjithsesi në situatën e krijuar, ai ishte pesimist se palët do të bashkëjetonin në paqe dhe se mundësitë për konflikt ishin evidente.

Në kontekstin e ngjarjeve që po ndodhnin, Heathcote-Smith i transmetonte Curzon edhe një portretizim të njeriut më të rëndësishëm të qeverisë Ypi, ministrit të Brendshëm, Ahmet Zogut i cili tani paraqitej me nota edhe më kritike se më parë. Sipas tij, “Zogu në politikën e brendshme, ka përdorur ose ka shpërdoruar pushtetin e tij, për të pasuruar veten, me qëllimin për ta përdorur këtë pasuri, për konsolidimin dhe rritjen e prestigjit të tij... Anulimi prej tij i zgjedhjeve të Drinit, ku ishin praktikisht të gjithë kundërshtarët e tij në Parlament, solli privimin e tyre nga postet politike dhe ishte një kryevepër në strategjinë e tij.”¹³ Kjo është një optikë mjaft interesante, e cila pasqyron disa nga karakteristikat e Zogut, të përmendura mjaft edhe nga kundërshtarët e tij politikë, të cilat i dhanë atij epërsi mbi ta, në atë labirint të komplikuar të politikës shqiptare të kohës.

Siç e pamë më lart deri në mars 1922 vlerësimet e misionit britanik përshkohen nga qëndrime dyshuese ose negative rreth veprimeve politike të Ahmet Zogut. Por, pas kryengritjes antiqeveritare të marsit 1922 këto vlerësime për veprimtarinë e tij ndryshuan dukshëm në kahun pozitiv. Pas shtypjes së revoltës të marsit, përfaqësuesi britanik Harry Eyres raportonte se, qeveria e kishte rritur dukshëm prestigjin e saj në vend, për shkak të rezistencës së suksesshme ndaj forcave përçarëse. Ai, ndoshta

¹² TNA, PRO. FO 371/7330, f. 620-623. Telegram i Heathcote-Smith për Curzon, në lidhje me A. Zogun, Ministrin e F. Të Brendshme, 18 shkurt 1922.

¹³ *Po aty*.

për herë të parë, po fillonte të shpresonte, se në qoftë se drejtuesit e kryengritjes ishin kapur, “mund të thuhet se ka një mundësi për qeverinë konstitucionale të përparojë”. Gjithsesi ai paralajmëronte se, “në kundërshtim me këtë, nuk mund të shpresohet se kontrolli i vrazhdë i zbatuar ndaj komplotistëve, do të sjellë paqen në vend për një kohë të gjatë”.

Eyres vlerësonte me superlativa A. Zogun për qëndrimin që mbajti gjatë krizës. “Nuk ka dyshim se Ahmet Zogu, Ministri i Punëve të Brendshme, ishte heroi i krizës. Pa të, qeveria do të kishte degraduar. Jam habitur me energjinë dhe kapacitetin e tij dhe tashmë ndihem më me shpresë për të ardhmen, që prej “coup d’etat” të Aqif Pashës.”¹⁴

Disa muaj pas kryengritjes, dhe pikërisht në verën e vitit 1922, qeveria Ypi kishte pasur kohë relativisht të mjaftueshme për të provuar veten e saj. Pikërisht në këtë kohë, diplomati britanik Robert Parr, i dërgoi një raport interesant Earl of Balfour, mbi qeverinë e Xhafer Ypit. Gjëja e parë që vlerësonte Parr, ishin përpjekjet që kishte bërë “Partia Popullore” për të ndërtuar një qeveri të qëndrueshme dhe ai pohonte se, deri diku, ia kishte arritur këtij qëllimi, ndonëse nuk kishin munguar forcat e brendshme dhe të jashtme destabilizuese. Parr shkruante: “Gjatë këtij viti qeveria ka qenë e shqetësuar për të hedhur bazat e një qeverisjeje të stabilizuar...”¹⁵.

Tashmë vlerësimet pozitive për veprimtarinë politike të A. Zogut po shtoheshin. R. Parr shpjegonte se pas grushtit të shtetit, zgjedhja e “Partisë Popullore” kishte rënë mbi Ahmet Zogun, i cili u veçua si i vetmi person që mund të merrej me situatën e brendshme dhe drejtuesit e partisë, të mbledhur në Elbasan, e emëruan atë ministër të Punëve të Brendshme dhe Xhafer Ypin, President të Këshillit. Pra, ai pohon se A. Zogu ishte zgjedhur si personi më i përshtatshëm që mund të stabilizonte qeverisjen, çka është mohuar nga historiografia e mëparshme, e cila e ka parë emërimin e Zogut, vetëm si produkt të ambicies së tij për pushtet.

Parr bënte edhe një analizë të detajuar mbi personalitetet dhe kontributet e anëtarëve të kabinetit Ypi. Interesante është paraqitja e profilit dhe veprimtarisë së ministrit të Brendshëm, për të cilin shkruante: “*Ahmet Zogu përfshin në personin e vet, të gjithë forcën qeverisëse të*

¹⁴ TNA, PRO. FO 371/7331, f. 441-442. Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, 29 mars 1922.

¹⁵ TNA, PRO. FO 371/7330, f.628-630. Telegram i Robert Parr për Earl of Balfour, mbi qeverinë e Xhafer Ypit, Durrës, 30 korrik 1922.

kabinetit... Është e vërtetë që ai nuk mund të bëjë gjithçka, por gjithçka që është bërë, është realizuar prej tij... ai ka vepruar jashtëzakonisht mirë dhe meriton mirënjohjen e vendit të tij.”¹⁶ Kjo tablo na ndihmon të nxjerrim disa përfundime. Së pari, evidentohet paaftësia qeverisëse e Xh. Ypit, e cila, sigurisht, ndikoi në rritjen e peshës së Zogut në qeveri, ndonëse ky nuk ka qenë faktori i vetëm; së dyti, Parr tashmë kishte ndryshuar rrënjësisht mendimin mbi personalitetin e Zogut, duke përmbysur mendimet e mëparshme dhe duke evidentuar se, ai kishte vepruar në mënyrën më të mirë të mundshme për qeverisjen e vendit. Ai hedh poshtë gjykimin e vet të mëparshëm dhe të kolegut të tij Smith, se Zogu po vepronte me metoda të kritikueshme, i udhëhequr vetëm nga ambicia e tij personale.

Të njëjtat vlerësime pozitive për A. Zogun bënte edhe Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve. Në një raport plotësues, më 13 maj 1922, ai shkruante: “Qeveria e drejtuar nga Ahmet Zogu, influenza mbizotëruese e të cilit është tashmë e padiskutueshme, ka treguar energji në rivendosjen e rregullit dhe ka qenë tërësisht e suksesshme në përpjekjet e saj. Pozita e tij pa dyshim është forcuar, për shkak të mënyrës së shpejtë dhe të suksesshme, në të cilën kjo krizë e rrezikshme u kapërcye.”¹⁷

Edhe përfaqësuesi britanik në Komisionin e Kufijve, nga ana e tij, shqyrtonte profilin e qeverisë Ypi. Ai konfirmonte edhe një herë raportimin e tij të mëparshëm, se qeveria aktuale shqiptare, duke qenë se ishte tërësisht italofobe, shprehte vetëm aspirata nacionaliste dhe nuk dyshohej se ishte serbofile.¹⁸ Kuptohet që këto vlerësime shkonin në radhë të parë për ministrin e Brendshëm, A. Zogu.

Komisioni Hetimor, luajti një rol pozitiv dhe ndihmoi në stabilitetin e vendit. Në raportin e përgjithshëm të këtij komisioni, më 12 prill 1922, thuhej se, gjatë krizës së dhjetorit 1921, prezenca e Komisionit në Tiranë, pati efekt të dobishëm dhe mund të themi se parandaloi gjakderdhjen. Por, me largimin e Komisionit, një konflikt i ri ndodhi, këtë radhë i provokuar nga Bajram Curri, një ish-kolonel i ushtrisë

¹⁶ *Po aty.*

¹⁷ TNA, PRO. FO 371/7329, f. 380-382. Raport plotësues i Komisionit të Hetimit në Shqipëri, 13 Maj 1922.

¹⁸ TNA, PRO. FO 371/7330, f. 720-732. Ngjarjet nga 1-31 maj 1922. Raport i Komisionerit britanik Hiles në Komisionin e Kufijve Serbo-Shqiptare, mbi qëndrimin e qeverisë shqiptare, Shkodër, 31 maj 1922.

shqiptare, i cili planifikoi përmbysjen e qeverisë së Xhafer Ypit dhe Ahmet Zogut dhe thirrjen e një Asambleje Nacionale Kushtetuese.

Një tjetër vlerësim i rëndësishëm i Komisionit Hetimor ishte ai në lidhje me politikën e qeverisë shqiptare kundrejt shtetit serbo-kroato-sllloven. Në raportin e tij, thuhej se “Komisioni ka insistuar në çdo rast të mundshëm, që shqiptarët duhet të heqin dorë nga ambiciet irredentiste” dhe se, “si rregull i përgjithshëm, opinioni publik në vend e kupton rrezikun e një politike të tillë.”¹⁹ Ky pohim, i cili përforcohet edhe me rekomandimet e shumta të përfaqësuesve britanike në Tiranë, vërteton drejtësinë e politikës së vetëpërmbytur të qeverive të kësaj kohe, e cila është komentuar gabimisht nga historiografia e mëparshme dhe nga opozitarët irredentistë të asaj kohe, të cilët kanë fajësuar kryesisht Zogun për këtë politikë, duke e akuzuar atë si serbofil. Komisioni vinte në dukje se “Shqipëria duhet të përpiqet të shmanget, sa më shumë të jetë e mundur, nga një politikë e jashtme aktive. Pika më thelbësore është që Shqipëria të gëzojë neutralitet të plotë, në mënyrë që t’ia kushtojë energjitë zhvillimit të saj konstitucional, ekonomik dhe social”.²⁰

Në tetor të vitit 1922, eksperti i Lidhjes së Kombeve, A. Calmes bëri një raport mbi situatën ekonomike dhe financiare në Shqipëri.²¹ Ai konstatoi se situata e brendshme politike në Shqipëri shënonte një përmirësim të dukshëm dhe puna e qeverisë për organizimin dhe paqëtimin e vendit, kishte sjellë “rezultate të shkëlqyera”. Kuptohet, në këtë vlerësim pozitiv të qeverisë Ypi, përfshihej edhe puna e ministrit të Brendshëm, Zogu. Sipas Calmes, vetëm pas shtypjes së trazirave të fundit të marsit 1922, mund të thuhej se qetësia mbizotëronte në Shqipëri. Në një periudhë të shkurtër, që kishte kaluar që nga ajo kohë, qeveria, me burimet e saj të pakta, kishte qenë e aftë të kryente disa nga detyrat e rëndësishme, për të cilat, kishin tentuar më kot më parë autoritetet turke, si dhe austriakët gjatë pushtimit të tyre.²²

Në vjeshtën e vitit 1922, britanikët fillojnë të shfaqin përsëri nota pesimiste për gjendjen në Shqipëri dhe qeverisjen e vendit. Robert Parr pohonte se situata e brendshme, në kontekstin e marrëdhënieve

¹⁹ TNA, PRO. FO 371/7329, f. 285-293. Raporti i përgjithshëm i Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve, 12 prill 1922.

²⁰ *Po aty*.

²¹ TNA, PRO. FO 371/7329, f. 474-505. Raport mbi situatën ekonomike dhe financiare në Shqipëri, A. Calmes, 20 tetor 1922.

²² *Po aty*.

armiqësore me fqinjët, po bëhej edhe më e rrezikshme. Ai tashmë konstatonte edhe një krizë të brendshme të qeverisë. Për këtë ai pohonte: “Qeverisja aktuale dhe administrata nuk përfaqësojnë të gjitha klasat në pushtet, dhe komandon më tepër frika sesa dashamirësia e njerëzve. Përveç Ahmet Beut, ato konsistojnë në një numër të vogël zyrtarësh të mbetur nga regjimi turk... Forca e vetme që mban koherencën është influenca personale e Ahmet Zogut. Ai i vetëm gëzon respektin e popullit... dhe mund të konsiderohet një lider i vërtetë në vend.”²³ Kjo tablo e trishtë e Parr, është tërësisht në kundërshtim me vlerësimet e derisotme të shumë historianëve shqiptarë. Për më tepër, në kundërshtim me pohimet e tyre, Zogu paraqitet si një faktor i vetëm kohezioni dhe stabiliteti, në një qeverisje të zhytur në një krizë të thellë, për shkak të dominimit të zyrtarëve të prapambetur të trashëguar nga administrata osmane.

Raporti i Parr, ka një rëndësi edhe më të madhe sepse na informon mbi planet dhe projektet e Zogut në nëntor 1922, në ato momente kritike që po kalonte “Partia Popullore” dhe qeveria e saj, e cila po gërryhej nga çarjet e thella të brendshme. Këto detaje interesante për të kuptuar historinë e kësaj periudhe, nuk kanë qenë të njohura deri më sot. Parr i shkruante Curzon: “Ideja e tij është të thërrasë bashkë të gjithë drejtuesit e fiseve dhe kryetarët e familjeve, për të formuar një qeveri me aprovimin dhe mbështetjen e tyre dhe për spastrimin e atyre që janë përgjegjës për gjendjen aktuale të punëve. Qeveria do të krijohet provizorisht mbi baza feudale. Shqipëria do t’i përgjigjet më mirë një qeverisjeje të tillë sesa çdo qeverisjeje tjetër”. Diplomati britanik, i shqetësuar për destabilitetin dhe furtunën politike që po afronte, duket se e vlerësonte pozitivisht këtë formë qeverisjeje të Shqipërisë dhe këtë projekt politik të A. Zogut. Nuk mund të thuhet me saktësi se sa e vërtetë ka qenë ekzistenca e këtij plani por fakt është se ai nuk u realizua dhe as që u propozua apo u tentua të vihej në jetë.

Parr gjithashtu zbulonte se, situata kritike e kishte shtyrë shumicën e Parlamentit t’i kërkonte Zogut marrjen e qeverisë në dorë, çka përbën një informacion tjetër me vlerë për të kuptuar se cilët ishin faktorët realë të ardhjes së Zogut në krye të qeverisë në dhjetor të vitit 1922. Parr shkruante: “Disa javë më parë, 52 deputetë ose mbase 60, i kërkuan atij

²³ TNA, PRO. FO 371/7332, f. 521-525. Telegram i Robert Parr për Curzon of Kedleston, mbi ngjarjet në Shqipëri, Durrës, 12 nëntor 1922.

t'i merrte çështjet në dorë. Ai refuzoi, duke argumentuar se nuk do të ishte e dobishme të hiqje me forcë një administratë, ndonëse të korruptuar, pa u siguruar se nuk mund të shërbente për të ndërtuar diçka tjetër. Të ndikojë në një *coup d'état* në këto momente, do të thoshte të merrje mbi shpatulla fajet për të gjitha abuzimet e administratës aktuale.”

Pra, del e qartë se, Zogu kishte kundërshtuar me vendosmëri një ndryshim me forcë të kabinetit. Mesa duket, pas kësaj, shumica ishte bindur se duhej bërë një ndryshim ligjor dhe përmirësimet në administratë, e cila paraqitej si thembra e Akilit e qeverisjes, të bëheshin jo në mënyrë drastike por, graduale dhe me më pak dhimbje e destabilitet.

Në fund të raportit të tij, Parr vinte në dukje, në formë definitive, se ishin dy masa që do të jepnin zgjidhjen e kërkuar për problemet me të cilat ballafaqohej Shqipëria. E para, ishte sigurimi i parave. Profesor Sederholm-i e konsideronte gjendjen tepër të rëndë dhe po i paraqiste Lidhjes gjendjen akute të financave qeveritare. E dyta, ishte shmangia e ndërhyrjeve shkatërrimtare të fqinjëve.²⁴

Siç u theksua më lart, marrja e postit të kryeministrit nga Zogu nuk lidhej me tendencat autokratike të tij por, në radhë të parë, me përçarjet brenda “Partisë Popullore” dhe pastaj me qëndrimin e ashpër të opozitës, faktor të cilët nuk janë vlerësuar sa duhet në studimet e derisotme. Për të kuptuar më mirë arsyet se, përse Zogu pranoi të merrte postin e kryeministrit, na shërben ky raport i përfaqësisë britanike për Markezimin Curzon të Kedlestonit, disa ditë pas formimit të qeverisës së tij: “Kam vënë re se, ndërsa është i dyshimtë avantazhi i Ahmet Zogut në pranimin e postit të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, shihet se ai nuk ka pasur pothuajse asnjë mundësi tjetër për këtë çështje. Mendoj se, në qoftë se do të kishte parë një rrugë tjetër, ai nuk do të kishte zgjedhur këtë moment të veçantë për të marrë përgjegjësinë kryesore të administrimit, duke parë që nuk kishte kolegë eficientë, me përjashtim të Pandeli Evangjelit. Ahmet Bej Zogu u përball me kërkesën e pjesës më të madhe të deputetëve që ai duhej të caktohej, dhe kështu bëri. Pa dyshim më parë, ai e gjeti të pamundur të punonte me Xhafer Ypin. Në qoftë se do të kishte refuzuar, do të kishte lindur një krizë...”²⁵

²⁴ *Po aty.*

²⁵ *TNA, PRO. FO 371/7330, f.658. Raport për Marquess Curzon of Kedleston, Durrës, mbi qeverinë e re të A. Zogut, 16 dhjetor 1922.*

Siç shihet më sipër, ky shpjegim është diametralisht i kundërt me atë që ka bërë historiografia e mëparshme dhe disa historianë të njohur sot, mbi arsyet dhe rrethanat e marrjes së postit të kryeministrit nga Zogu. Madje, prej këtij raporti del se Zogu e pranoi postin e kryeministrit pa dëshirë, për shkak të situatës politike të asaj kohe, dhe se ai u detyrua nga rrethanat për të shmangur një krizë të rrezikshme politike.

Britanikët do të rikonfirmonin të njëjtat pikëpamje lidhur me arsyet e marrjes së qeverisë në dorë nga Zogu edhe dhjetë muaj më vonë. Në tetor të vitit 1923, Robert Parr e shpjegonte kështu marrjen e postit të kryeministrit nga Zogu: “Kur A. Zogu u bë kryeministër, në fillim të dhjetorit, ishin dy arsye për caktimin e tij: e para ishte prestigji i tij në gjithë vendin dhe e dyta ishte frika që ndjente “Klika”, për shkak të armiqësisë ndaj saj në jug.”²⁶ Ardhjen e Zogut në krye të qeverisë, diplomati britanik e lidhte me gjendjen e “Klikës” ose më konkretisht me përçarjet brenda saj.²⁷

Për të kuptuar se me çfarë vështirësish u ndesh shteti shqiptar, në procesin e konsolidimit të tij institucional, mjafton të analizojmë me kujdes dhe në mënyrë kritike, raportin e Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, i cili erdhi në Shqipëri në vitet 1922-1923. Konstatimet e tij përbëjnë një dokument themelor të një organizmi ndërkombëtar, i cili ka pasur jo vetëm vlerë juridike por, njëkohësisht edhe historike. Ky dokument pasqyron problemet dhe konceptet e atëhershme ndërkombëtare, për funksionimin e institucioneve kombëtare të shqiptarëve, të cilat ishin në procesin e ndërtimit dhe plotësimit të tyre, duke sfiduar pengesat që u ishin vënë përpara në të shkuarën. Këto probleme ishin në fokusin qendror të Lidhjes së Kombeve dhe organizmave të saj.

Në një nga komentet e rëndësishme të këtij raporti thuhej: “nuk mund të pretendoj se drejtësia është më e keqe se sa në shtetet e tjera të Ballkanit. Në disa raste fshatarët si dhe grekët (fshatarë) më deklaruan, me një sinqeritet të dukshëm, se sigurimi publik ishte i kënaqshëm. Unë mendoj se siguria publike, qetësia, ka bërë hapa të mëdha përpara në Shqipëri gjatë dy vjetëve të fundit, në raport me gjendjen në kohën e

²⁶ TNA, PRO. FO 371/8535, f. 1148-1149. Telegram i Parr për Curzon, mbi situatën politike në Shqipëri, 15 tetor 1923.

²⁷ *Po aty.*

Turqisë.”²⁸ Kjo ishte dëshmi, se procesi i stabilizimit dhe i vendosjes së qetësisë, me gjithë vështirësitë, po ecte përpara dhe kjo e dhënë përputhet me shumë fakte të tjera që provojnë progresin në qeverisjen e vendit gjatë viteve 1922-1923. Këto konstatime vlejnë për të kuptuar edhe qëndrimin e këtij Komisioni ndaj qeverisë së kryesuar nga Zogu e cila kishte rreth dy muaj që ishte krijuar kur u shkruajt ky raport.

Komisioni Hetimor konkludonte se, reformat administrative ishin vënë pjesërisht në programin e kësaj qeverie, por theksonte se “ishite shumë e rëndësishme të zbatoheshin menjëherë.”²⁹ Kryetari i Komisionit, Profesori Sederholm, pasi pohonte se Shqipëria e gjente veten me një sistem të pamjaftueshëm rrugor e arsimor, pa një administratë efektive, pa një legjislacion modern, e vinte theksin tek puna shumë e mirë dhe efektive e qeverisë së Zogut në të gjitha drejtimet kryesore. Sipas tij, “qeveria, nën udhëheqjen energjike dhe të aftë të udhëheqësit të ri Ahmet Zogut”, që kishte “ushtruar një influencë mbizotëruese”, e kishte shtypur lehtësisht të vetmen kryengritje të organizuar në vend [bëhet fjalë për kryengritjen antiqeveritare të marsit 1922], kishte kryer çarmatimin e popullsisë, kishte ulur gjakmarrjen, kishte pakësuar vjedhjen, “e cila më parë në disa rajone të jugut të Shqipërisë ishte një formë e rregullt e jetesës”.³⁰

Ndryshe nga sa është shkruar nga historiografia e mëparshme, se Zogu ndiqte një politikë filoserbe, ministri britanik, Eyres, njoftonte në mënyrë të përsëritur dhe me këmbëngulje Sekretarin e Jashtëm Curzon se, “Nuk është e drejtë të flasësh për tendencat serbofile të qeverisë shqiptare. Unë në disa raste, e kam kundërshtuar faktin se kjo qeveri ka treguar shenja për tendenca ndaj çdo shteti fqinj. Politika e saj ka qenë, përkundrazi, zhvillimi i marrëdhënieve miqësore me Greqinë, Jugosllavinë dhe Italinë, edhe pse metodat e tyre kanë qenë në disa raste joefektive. Ahmet Zogu është intensivisht dyshues për Jugosllavinë dhe Italinë dhe i pasigurt për Greqinë, por dëshiron të mbajë marrëdhënie të mira me të gjithë”.³¹

²⁸ AMPJ, V. 1923, D. 211, fl. 3-31. Raport i Komisionit Hetimor të LK për Shqipërinë, në periudhën kohore 19 dhjetor 1922 - 1 shkurt 1923.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ TNA, PRO. FO 371/8535, f. 1090-1092. Telegram i Eyres për Curzon, mbi situatën në Shqipëri, Durrës, 9 qershor 1923.

Vitet 1922-1923, ishin më të suksesshme në procesin e konsolidimit të shtetit në forcimin e institucioneve kombëtare në raport me periudhën paraardhëse. Në këtë mënyrë janë vlerësuar pozitivisht nga historianë seriozë të huaj dhe nga përfaqësues të diplomacive të kohës. Por, siç do të shihet më tej, kjo periudhë qeverisjeje pozitive, veçanërisht po të kemi parasysh kushtet e Shqipërisë, do të rrënohet kryesisht nga përçarjet në vetë qeverinë e A. Zogut.

Vështirësitë në radhët e “Partisë Popullore” ishin shfaqur në mënyrë periodike qysh prej fundit të vitit 1921, por kriza e parë serioze ishte ajo e verës 1923 kur ministri Spiro Koleka, pasi kundërshtoi në Parlament projektin e qeverisë së tij për dhënien e koncensionit të naftës Shoqërisë britanike “Anglo Persian Oil Company”, dha dorëheqjen.

Kriza e verës u pasua me atë të vjeshtës, e cila ishte edhe më e thellë dhe më e rrezikshme. Këtë herë nuk ishte vetëm Spiro Koleka por, një grup më i madh deputetësh të “Partisë Popullore” që po dilnin kundër qeverisë. Në fund të shtatorit, Eyres njoftonte Londrën se kabineti i Ahmet Zogut “po kalon një krizë serioze, e cila duket se po e gërryen atë.” Ai e shpjegonte krizën e re, si rezultat të ballafaqimit të Zogut me disa deputetë kosovarë, të cilët kërkonin një politikë aktive irredentiste. Ky është një shpjegim tjetër interesant i krizës së vjeshtës 1923, e cila për pak sa nuk degradoi në një grusht shteti.

Eyres e vlerësonte shumë pozitivisht qëndrimin e Zogut ndaj krizës. Prandaj ai i shkruante Sekretarit të Jashtëm: “Ai pa dyshim ka vepruar me një kurajo të madhe, duke e liruar veten nga një sundim kaq i dëmshëm, i cili ka dëmtuar seriozisht qëllimet e tij të mira, dhe është thelbësisht i dëmshëm për Shqipërinë, por mbetet për t’u parë nëse do të jetë i fortë mjaftueshëm për ta mbajtur veten në fuqi pa këto mbështetës.”³²

Gjendjen e vështirë të qeverisë së Zogut, në vjeshtën e vitit 1923, e përshkruante edhe Parr, i cili e kishte kuptuar se, një pjesë e “Klikës” që ishte rreshtuar kundër A. Zogut, tashmë kishte filluar të bashkohej me opozitën e drejtuar nga Gurakuqi dhe po ndërtonte një kauz të përbashkët me të. Parr nënvizonte: “*Rrymat e nënkuptuara nga Italia dhe Jugosllavia dhe rivendosja e marrëdhënieve mes mbetjeve të gjysmës së “Klikës dhe Gurakuqit” - një rivendosje e marrëdhënieve në të cilën ky i*

³² TNA, PRO. FO 371/8535, f. 1145-1146. Telegram i Eyres për Curzon, mbi pushtetin e Ahmet Zogut, 26 shtator 1923.

*fundit shpresonte të përdorte të parën si një shkallë për të marrë fuqinë, gradualisht kristalizuan opozitën ndaj tij...*³³ Ai e përshkruante me detaje situatën e krijuar dhe pohonte se ishte në dijeni të plotë të saj.³⁴

Në këto momente kritike u shfaqën hapur tiparet më negative të “Partisë Popullore” dhe të boshtit të saj “Krahu Kombëtar” ose “Klikës”. Një pjesë e anëtarëve të saj përgatiti një grusht shteti i cili do të realizohej me vrasjen e Kryeministrit më 28 nëntor 1923. Përfaqësia britanike më 1 dhjetor 1923, jepte të dhëna konkrete për grushtin e shtetit të mbetur në tentativë. Robert Parr informonte se, “në fund të shtatorit, sesioni i Parlamentit përfundoi dhe u bë e qartë për “Klikën” që influenca e A. Zogut po rritej në gjithë vendin. Me mbështetjen e një prej Regjentëve, ministrit të Punëve Publike dhe të Arsimit, dhe drejtuesit të Xhandarmërisë, “Klika” përgatiti një ‘coup d’etat’ ”.³⁵

Në këtë situatë tepër kritike, Eyres informonte edhe për dilemat që kishte pasur Zogu i cili u informua për komplotin.

Zogu ndoqi rrugën më të zgjuar dhe u konsultua me ministrin britanik për masat që duhej të merrte, i cili sigurisht i sugjeroi rrugën më demokratike dhe paqësore por, edhe që të ruante stabilitetin. Eyres pohonte: “I thashë atij, se do ta mbështesja për sa kohë që shihja se veprimet e tij ishin të drejtuara nga dy parime: së pari, nga nevoja për ngritjen e një qeverie të stabilizuar në vend dhe së dyti, ai duhet të evitonte të gjitha veprimet, ligjërisht antikonstitucionale.”³⁶

Nga informacionet e misionit britanik rezulton se Zogu kishte dëshirë t’i shtypte me forcë komplotistët, por ai veproi sipas arsyes, duke zbatuar sugjerimet e britanikëve dhe jo në bazë të dëshirës. Robert Parr shkruante: “Ai ndjente se kishte një mundësi unike për të liruar vendin nga ankthi i “Klikës”. Por në fund vendosi të vepronte në përputhje me kushtetutën.”³⁷

Nga ana tjetër misioni britanik dekurajoi grupin e komplotistëve që iu drejtua atij për ndihmë dhe së bashku me përfaqësinë e Italisë dhe

³³ TNA, PRO. FO 371/8535, f. 1148-1149. Telegram i Parr për Curzon, mbi situatën politike në Shqipëri, 15 tetor 1923.

³⁴ Po aty.

³⁵ TNA, PRO. FO 371/8535, f. 1182-1192. Telegram i Parr për Curzon, mbi pozitën e A. Zogut në vend, Durrës, 1 dhjetor 1923.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

SHBA deklaruan mosnjohjen e një qeverie që do të krijohet në rrugë të tillë antiligjore. Burimet britanike janë të mjaftueshme dhe bëjnë të qartë, si ekzistencën reale të komplotit ashtu edhe tejkalimin e situatës së rëndë, si rezultat i ndihmës që dhanë përfaqësuesit britanikë në dy drejtime: a- duke i dhënë këshilla Zogut që të reagoje me maturi dhe me frymë kompromisi për të shmangur fillimin e një lufte civile, këshilla të cilat, Zogu i vuri në zbatim; b- duke dekurajuar autorët e grushtit të shtetit që po përgatitej të cilët gjithashtu u tërhoqën nga ky veprim i rrezikshëm. Parr pohonte se grushti i shtetit “u shmang nga përfaqësuesit e huaj, të cilët kërcënuan me mos-njohjen.”³⁸

Por, ndonëse konflikti kishte kaluar për momentin, ai nuk ishte mbyllur dhe të dyja palët përgatiteshin për përleshje në të ardhmen. Parr pohonte se, “A. Zogu mendon se pozita e tij do të fuqizohet pas zgjedhjeve dhe do të jetë i aftë të merret me komplotistët.”³⁹

Ndërkohë, Parr e kishte thëlluar mendimin më negativ për “Klikën”. Ai, Smith dhe Eyres gjatë viteve 1921-1923, kishin njoftuar gjithmonë për dyshime dhe për rreziqe që vinin prej organizimit dhe natyrës së kësaj shoqërie sekrete por, tashmë gjykimi i tyre ishte bërë shumë më tepër kritik dhe e çmonin atë si burimin e të gjitha të këqijave të sistemit politik të Shqipërisë.⁴⁰ Fatkeqësisht, ky parashikim i Parr do të rezultonte i saktë. Një pjesë e “Klikës” dhe opozita do të bashkoheshin bashkë në kryengritjen e qershorit, duke shkatërruar sistemin parlamentar të qeverisjes në Shqipëri.

Misioni britanik na ka dhënë edhe një material me vlerë mbi pikëpamjet politike të A. Zogut lidhur me formën e regjimit që duhej të vendosej në Shqipëri pas thirrjes së Asamblesë Kushtetuese. Qysh në gusht 1923, kur ishte në prag fillimi i fushatës elektorale për zgjedhjet që do të zhvilloheshin për Asamblenë Kushtetuese, ministri britanik nënvizonte synimin e qeverisë së Zogut, për të ruajtur institucionin e Këshillit të Lartë. Eyres informonte Londrën se: “qeveria ka dëshirë të thërrasë Asamblenë Kushtetuese në fund të vitit. Çështjet që duhet të vendosen janë forma përfundimtare e qeverisjes për Shqipërinë, përzgjedhja e kryeqytetit dhe pika të tjera shtesë. Statutet e Kongresit të Lushnjës janë të përkohshme dhe Asambleja do të thirret për t’i

³⁸ *Po aty.*

³⁹ TNA, PRO. FO 371/8535, f. 1181. Tentativa e një *coup d’etat* në Shqipëri. Telegram i Parr për FO, Durrës, 1 dhjetor 1923.

⁴⁰ *Po aty.*

transformuar këto rregulla në një kushtetutë të përhershme, me disa modifikime që mund të konsiderohen të nevojshme. Në qarqet qeveritare shfaqen tendenca për mbajtjen e Këshillit të Regjencës.”⁴¹ Pra, spikat vendosmëria e A. Zogut për të kërkuar në Asamble përjetësimin e sistemit politik të përcaktuar nga Kongresi i Lushnjës dhe, më tej, nga Statuti i Zgjeruar i Lushnjës, që ishte një sistem demokratik. Ky mendim dhe qëllim politik, i është mohuar A. Zogut nga historiografia e mëparshme.

Por, ndonëse ishte ithtar i shndërrimit të dispozitave të Statutit të Zgjeruar të Lushnjës në norma kushtetuese, A. Zogu e kuptonte mirë vështirësinë që kishte aplikimi i tyre në rrethanat e Shqipërisë. Prandaj, ai propozonte një zgjidhje interesante për kapërcimin e këtij ngërçi. Zogu e thotë qartë dhe hapur se, për të shmangur pasojat e këtij sistemi demokratik, i cili për kushtet e Shqipërisë ishte shumë i avancuar, ai kishte në mendje disiplinimin brenda partive politike, duke u bazuar në parimin e transparencës së tyre përballë opinionit publik. Ajo që kërkonte Zogu, ishte një parti politike me një disiplinë ushtarake. Këtu ka baza për të hamendësuar se, ai mendonte një drejtim politik autoritar të partisë, të cilin e shihte si shansin e vetëm për të ruajtur qeverisjen dhe disiplinën në radhët e pozitës por, edhe unitetin e opozitës, nëse ajo kalonte në opozitë. Pra, në mendjen e tij ishte ngulitur fakti se, vështirësia që krijonte sistemi demokratik i qeverisjes në stabilitetin e vendit, duhej kundër balancuar me një disiplinë dhe kontroll brenda radhëve të partive politike të kohës.

Me gjithë krizën e vjeshtës dhe të dimrit të vitit 1923, në përgjithësi, ky vit i qeverisjes së Zogut ishte i qetë, ndonëse retë e konfliktit nuk u shpërndanë asnjëherë. Këtë gjë e pohonte edhe ministri britanik, i cili pohonte se, “viti 1923 ka kaluar më qetë vitet e mëparshme që nga fillimi i Pavarësisë shqiptare të cilët kanë qenë të vështirë për shkak të agresionit të jashtëm dhe fraksionimit të brendshëm. Me një përjashtim të parëndësishëm, nuk pati asnjë rekurs për forcë të armatosur”.⁴²

Por Eyres vinte në dukje se gjithçka ishte arritur me një sforco të madhe dhe shprehte vlerësime tejet kritike për klasën politike shqiptare.

⁴¹ TNA, PRO. FO 371/8535, f.1130-1131. Telegram i Eyres për Curzon, mbi sesionin special të parlamentit më 20 gusht 1923 dhe zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, dt. 5 gusht 1923.

⁴² TNA, PRO. FO 371/9643, f. 3175-3186. Raport vjetor i Eyres për vitin 1923 drejtuar Macdonald, Durrës, 9 shkurt 1924.

Ai nënvizonte: “Është e dyshimtë nëse përpjekjet e këtij shteti kanë pasur progres real drejt një stabiliteti më të madh, qoftë administrativ ose financiar. Përpjekjet kryesore të të gjithë politikanëve, duket se janë fokusuar në mosmarrëveshjet personale, pa marrë parasysh nevojat e vendit.”⁴³ Pra, këtu ai bënte një vlerësim negativ, por real, të të gjithë klasës politike shqiptare të kohës, të cilin e konsiderojmë si më të saktin dhe më të balancuarin, duke pasur parasysh ngjarjet historike që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Tashmë, Eyres mbante një qëndrim kritik edhe ndaj Zogut, por përsëri duke e veçuar këtë të fundit, si më pozitivin në këtë grup politikanësh ambiciozë dhe konfliktualë, që nuk kishin aspak vizion për qeverisjen e vendit të tyre. Ai shkruante: “Edhe pse Ahmet Zogu nuk mund të akuzohet për mungesë patriotizmi as për verbëri ndaj kushteve të Shqipërisë, ai e lejoi veten të ishte vegël e fraksioneve, ndërsa ai më kot besonte se po kalonte stuhinë. Nuk ka dyshim se, A. Zogu është më tepër i aftë si Ministër i Punëve të Brendshme se sa si Kryeministër ... Ahmet Beu, pa dyshim, e përcaktoi drejt pozitën e tij, por ishte tepër dëshpëruese të shihje përpjekjet e tij për t’u liruar nga rrethi. Ai vendosi tepër besim në kapacitetet e tij për intriga dhe dështoi në adoptimin e kursit të tij të drejtpërdrejtë.”⁴⁴ Ky është përsëri një përcaktim shumë interesant dhe objektiv i figurës së Zogut, të cilin ne nuk e kemi ndeshur më parë. Duke pasur parasysh ngjarjet që ndodhën gjatë qeverisjes së tij, kjo analizë e Eyres duket realiste dhe e saktë.

Pas përfundimit të sesionit parlamentar, e gjithë vëmendja u përqendrua te zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të zhvillohej në fund të dhjetorit. Sipas Eyres, gjithçka tregonte mundësinë e A. Zogut për të rritur mbështetjen e tij në vend. Prestarët e “Klikës” e dinin shumë mirë se kjo do të ishte zhdukja e tyre politike. Ata, në përputhje me rrethanat, ranë dakord bashkërisht se meqë A. Zogu po mundohej të kthehej në Parlament me një numër të madh kandidatësh, të cilët sipas tyre nuk ishin të përshtatshëm të përfaqësonin vendin, ishte e nevojshme që të gjithë “patriotët” t’i kundërviheshin manovrave të tij dhe të siguronin lirinë e zgjedhjeve. Për këtë ata u mbështetën nga opozita e drejtuar nga Gurakuqi dhe Fan Noli.⁴⁵ Këtu kemi një shpjegim interesant,

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

të arsyeve të çarjeve që ndodhën në partinë qeverisëse dhe motiveve që e nxitën një pjesë të saj për t'u bashkuar me opozitën në fushatën zgjedhore për Asamblenë Kushtetuese.

Që në momentet e para pas zgjedhjeve, Eyres fliste për mundësinë e krijimit të një qeverie të qëndrueshme nga A. Zogu pas zgjedhjeve të vitit 1923, ç'ka në fakt nuk do të rezultonte e tillë. Ai shkruante: "Duket se kur të mbledhet Parlamenti, Zogu do ta gjejë veten me një maxhorancë mjaftueshmërisht të fortë për të qeverisur. Detyra e tij, megjithatë, do të jetë delikate, kryesisht prej disa elementëve të rinj në parlament. Përshtypja ime është se ai është zhgënjyer dhe demoralizuar nga rezultati i zgjedhjeve".⁴⁶ Ndërsa në raportin vjetor për vitin 1923, Eyres e paraqiste kështu rezultatin e zgjedhjeve: "Në ditët e fundit të dhjetorit zgjedhjet përfunduan dhe rezultatet nuk ishin të qarta. Nga 102 vende, 50 u morën nga ndjekësit e Ahmet Zogut.. Qeveria po bën bisedime për çështjet e mbetura pezull me grupet e tjera, por situata është shumë e tensionuar."⁴⁷

Zgjedhjet e reja, në vend të stabilitetit dhe të normalitetit demokratik, sollën radikalizimin e situatës. Rezultatet e tyre krijuan një situatë kaotike me perspektiva të errëta e të frikshme. Asnjë palë nuk ishte në gjendje të formonte shumicën e nevojshme për një qeveri të qëndrueshme e të fortë. Bejlerët bashkë me Zogun, s'mundën të fitonin shumicën që parashikonin. Deputetët e Shkodrës e të Kosovës, në fillim, nuk u bashkuan me asnjërën palë.

Misioni britanik i ndoqi me kujdes ngjarjet dramatike të gjysmës së parë të vitit 1924, duke i analizuar ato kurdoherë në këndvështrimin e stabilitetit dhe respektimit të legjitimitetit të vendit. Në këtë këndvështrim ai analizoi edhe kompromisin e arritur midis shumicës dhe opozitës në prill të këtij viti për futjen e disa përfaqësuesve të saj në qeveri. Lëvizjet në qeveri, në këtë kohë, ndryshuan dukshëm disa balanca politike, të cilat ministri britanik, Eyres i vlerësonte me mprehtësi si shumë pozitive për vendin. Ai njoftonte kryeministrin MacDonald se "pas disa javësh pavendosmërie dhe intrigash, kabineti ka vendosur eventualisht të përfshijë grupin e deputetëve të Shkodrës dhe ato të

⁴⁶ TNA, PRO. FO 371/9639, f. 720. Telegram i Parr për Curzon, mbi rezultatet e zgjedhjeve në Shqipëri, Durrës, 31 dhjetor 1923.

⁴⁷ TNA, PRO. FO 371/9643, f. 3175-3186. Raport vjetor i Eyres për vitin 1923 drejtuar Macdonald, Durrës, 9 shkurt 1924.

Kosovës dhe të heqë dorë nga mbështetja e grupit të Korçës.”⁴⁸ Pra, Eyres konfirmonte se ishte fituar mbështetja e dy grupeve më të fuqishme dhe njëkohësisht më agresive të opozitës, çka mund të hapte perspektivën për stabilitet. Gjithashtu ai zbulonte se, marrëveshja kishte qenë e vështirë pasi “çmimi i kërkuar nga grupi i Shkodrës në fillim ishte tre portofole, Lufta, Financat dhe Arsimi, por aktualisht Luigj Gurakuqi u caktua ministër i Financave dhe dr. Fahri (Gjilani) i Kosovës, ministër i Arsimit.” Ai pohonte se kabineti tashmë ishte i plotësuar me një përjashtim, por dobësia dhe mungesa e stabilitetit të tij ishin të dukshme. Në fakt ky ishte lëshimi i dytë që i bëhej opozitës nga partia e drejtuar nga Zogu, pas dorëheqjes së tij nga posti i kryeministrit dhe largimi nga qeveria. Këto lëvizje sigurisht që vlerësoheshin pozitivisht nga diplomatët britanikë, përderisa ato i shërbenin uljes së tensionit midis shumicës dhe opozitës.

Një përfitim tjetër të kësaj zgjidhjeje të re politike, Eyres cilësoonte, “eliminimin” e grupit të Korçës, pra largimin e tij nga qeverisja pasi këtë e vlerësoonte si “një goditje e fortë për “Klikën””, dhe “ky ishte një veprim për t’u përgëzuar nga miqtë e Shqipërisë”, theksonte ai. Vlerësimet konstante dhe tepër negative të Eyres për “Klikën” duhen analizuar me kujdes, pasi ai pa tek kjo organizatë një bërthamë konspirative të fuqishme dhe të organizuar, e cila ishte e aftë që në çdo çast të kapte shtetin. Këto vlerësime negative fillonin që në vitin 1921, kur “Klika” nuk kishte ndonjë rekord në veprimtarinë antikushtetuese dhe pastaj kritikën e tij u bënë më të forta gjatë viti 1923, kur ajo u fut në konflikt të hapur me Zogun dhe u shndërrua në qendër intrigash dhe të organizimit të grushteve të shtetit.

Edhe në këto çaste kritike Harry Eyres i kthehej figurës së Zogut, të cilin e vlerësoonte si të domosdoshëm që të rimerrte postin e ministrit të Brendshëm. “Shqiptarëve u duhet një dorë e fortë në postin e Ministrit të Brendshëm, dhe Ahmet Zogu, me të gjitha fajet e tij, është tepër i kërkuar”, i shkruante ministri britanik kryeministrit MacDonald⁴⁹

Kryengritja antiqeveritare e qershorit të vitit 1924 u vlerësua me nota shumë negative nga të gjithë miqtë e Shqipërisë në atë kohë por,

⁴⁸ TNA, PRO. FO 371/9639, f. 744-745. Telegram i Eyres për MacDonald, mbi situatën politike, Durrës, 24 prill 1924.

⁴⁹ *Po aty.*

edhe nga qarqet diplomatike të Fuqive të Mëdha, të cilat e analizuan këtë ngjarje në bazë të interesave të tyre, thelbi i të cilave ishte stabiliteti në Ballkan dhe, në funksion të tij, edhe stabilizimi i shtetit shqiptar dhe institucioneve të tij. Midis tyre spikat një vlerësim i H. Eyres, i cili, padyshim ishte njohësi më i mirë i politikës shqiptare të kohës. Ditën e triumfit të kryengritjes ai i shkruante kryeministrit Macdonald: *“Tashmë kanë kaluar 3 vjet e gjysmë që kur Shqipëria u pranua në LK dhe 2 vjet e gjysmë që kur qeveria shqiptare u njoh de jure dhe de facto nga qeveria britanike... Në qoftë se Shqipëria do të kishte që në atë kohë një kryetar shteti të fortë, me pak dyshime, mendoj se do të kishte sjellë si rezultat një qeverisje të qëndrueshme.”*⁵⁰ Pra, Eyres ia ngarkonte fajin e këtij dështimi kaq të rëndë sistemit politik, i cili me të vërtetë ishte i papërshtatshëm për kushtet e Shqipërisë së asaj kohe. Nga ana tjetër, kjo pikëpamje e argumentuar edhe në studime dhe burime të tjera, përbën një zhvendosje tërësore të fokusit të analizës nga objektivi klasor ideologjik, që ka pasur një pjesë e madhe e historiografisë shqiptare, në atë shtetformues dhe institucional, i cili duhej të ishte dhe prioriteti themelor kombëtar i shqiptarëve, në atë periudhë tepër të vështirë të fillesave të jetës shtetërore.

Eyres trajtonte edhe situatën konkrete të shoqërisë shqiptare. Ai shkruante: *“Shqiptarët, edhe pse janë të racës ariane dhe gjeografikisht evropianë, kanë pikëpamje orientale, për shkak të dominimit turk. ...Një popullsi tërësisht e paarsimuar, nga e cila u formua një klasë politike injorante, që përbëhej nga persona, më tepër të dhënë pas intrigave, sesa pas mbështetësve të tyre. Dhoma e Parlamentit u bë një skenë grindjesh mes deputetëve, të cilët kishin pikësynim vetëm interesat e tyre personale.”* Me këtë përcaktim, Eyres jepte sintezën e jetës politike parlamentare shqiptare, e cila rezultoi një dështim i vërtetë, si nga produkti politik që doli prej saj, pra destabiliteti dhe tensioni që i shkaktoi vendit, ashtu edhe nga pikëpamja e performancës institucionale dhe mesazhet që ajo i transmetoi shoqërisë shqiptare, në drejtim të emancipimit politik të saj.

Eyres gjithsesi, përpiquej të evidentonte edhe ndonjë element pozitiv në këtë sistem politik dhe grup politikanësh problematikë. Ai shkruante: *“Natyrisht, kishte disa përjashtime edhe pse pak dhe jo aq të shkëlqyera.*

⁵⁰ TNA, PRO. FO 371/9644, f. 1290-1293. Telegram i Eyres për Macdonald, Durrës, 10 qershor 1924.

Ndërmjet këtyre qëndronte dukshëm Ahmet Beu, si një burrë patriot dhe energjik. Ai kishte gjithashtu edhe një cilësi tjetër, shumë të rrallë në Shqipëri- ai nuk ishte i frikësuar nga puna. Kur erdhi në fuqi, në fillim të vitit 1922, në krye të “Partisë Popullore”, fatkeqësisht, shtylla e partisë ishte e ashtuquajtura “Klikë”.⁵¹ Pra, Eyres veçonte si shembullin kryesor pozitiv Ahmet Zogun. Ky është një përcaktim diametralisht i kundërt me imazhin që ka krijuar shumica e historiografisë shqiptare për rolin e tij gjatë kësaj periudhe dhe prandaj duhet analizuar me imtësi. Ndërsa segmentin e “Partisë Popullore” që iu kundërvu Zogut gjatë viteve 1923-1924 ai e cilësonte një pengesë dhe fatkeqësi për stabilizimin e shtetit dhe qeverisjes.

Eyres jepte në këtë rast edhe një shpjegim interesant mbi evoluimin e qëndrimeve dhe marrëdhënieve politike të A. Zogut me “Klikën”. Ai evidentonte rolin pozitiv të Zogut dhe pengesat që i erdhën atij nga “Klika”. Kjo është një tablo tërësisht e përmbysur në raport me sa ka shkruar historiografia shqiptare. Mendoj se Eyres ishte më objektiv dhe i paanshëm në gjykimet e tij dhe njëkohësisht nuk mund të vihet në pikëpyetje formimi i tij dhe informacioni që ai kishte për jetën politike dhe politikanët shqiptarë.

Si përfundim, mund të themi se, vështruar nga optika e misionit britanik, qeverisja në Shqipëri ndeshi në sfida serioze por, njëkohësisht ishte edhe institucioni që shënoi arritjet më të spikatura. Vitet 1922-1923, ishin më të suksesshme në procesin e konsolidimit relativ të shtetit dhe forcimit e zhvillimit të institucioneve kombëtare. Në përballjen titanike me krizat e rënda të viteve 1921-1923, spikat Ahmet Zogu, si element qendror pozitiv dhe stabilizues, megjithëse edhe veprimtarinë e tij britanikët e panë me sy kritik, duke evidentuar të metat që ai kishte, të cilat i kemi parashtruar më lart. Këto vlerësime dhe analiza në gjykimin tonë kanë qenë përgjithësisht të sakta dhe na shërbejnë për të kuptuar më mirë thelbin e zhvillimeve politike të kësaj periudhe.

Si rezultat i këtyre krizave, A. Zogu në vitin 1923 do të arrinte në përfundimin realist se, në rrethanat e Shqipërisë së asaj kohe, ishte shumë i vështirë zbatimi i sistemit parlamentar dhe pluripartiak të qeverisjes. Ai, me siguri, që në këtë kohë, filloi të mendojë për një formë më autoritariste qeverisjeje dhe të ndërtimit të institucioneve, e cila vërtet ishte një

⁵¹ *Po aty.*

shmangie dhe cenim i demokracisë, por ishte e vetmja mënyrë, për të eliminuar, të paktën për një farë kohe, krizat e rënda shpërbërëse të institucioneve shtetërore. Në programin e tij elektoral të vitit 1923, A. Zogu shpalsi hapur domosdoshmërinë e krijimit të një partie me një disiplinë ushtarake pra, propagandoi autoritarizmin partiak por, duke ruajtur formën parlamentare të qeverisjes dhe duke pranuar opozicionin legal të institucionalizuar. Kjo shkallë më e lehtë e shfaqjes së autoritarizmit u konceptua prej tij, si e keqja më e vogël, e domosdoshme për rrethanat e Shqipërisë. Ky mendim dhe projekt politik ishte reflektim korrekt ndaj krizave të rënda të qeverisjes në vitet 1920-1923 dhe veçanërisht i krizave dhe përçarjeve të dhimbshme brenda “Partisë Popullore” dhe “Krahut Kombëtar” ose të “Klikës”, siç u quajt me ironi nga opozita dhe diplomatët britanikë.

Ndërsa kryengritja e qershorit 1924, do ta shtynte Zogun në mënyrë përfundimtare, drejt përpjekjeve për vendosjen e një regjimi autoritarist, pa opozitë, të cilin e bëri realitet pas rikthimit të tij në pushtet, në dhjetor të këtij viti. Megjithatë, thelbi i këtij rikthimi dhe i regjimit që ai ndërtoi, ishte respektimi i formave ligjore e kushtetuese.

S u m m a r y

THE POLITICAL PROFILE OF AHMET ZOGU IN 1921-1924 UNDER THE OPTICS OF BRITISH DIPLOMATS

The process of governing in Albania in 1920-1924 came across serious challenges but in the mean time it was also the institution that marked the most outstanding achievements. Eyres and other British diplomats blamed the diplomatic system for such a big failure, as it was really totally inappropriate for the circumstances Albania was in at the time. On the other hand this viewpoint which is fully defended, be it in this paper, or in other studies and sources, presents a full set of focus of the analysis from the ideological class target, that a great part of our historiography has had, to that of the state-constructing and institutional one which was the main national priority of Albanians in that pretty hard time of the beginnings of a state life.

In the titanic confrontation with the heavy crisis of 1921-1923 Zogu would come to the realistic conclusion that under the circumstances of Albania at that time the application of the parliamentary and pluralistic system of governing was very difficult. He definitely started to think since then about a more authoritarianistic way of governing and setting up of institutions, what in fact was a deviation and violation of democracy, but it was the only way, at least for a certain period of time, to eliminate the heavy disintegrating crises of state institutions. In his electoral program of 1923 he displayed openly the necessity of creation of a party with military discipline, so he propagated party authoritarianism but keeping the parliamentary form of governing and accepting legal institutionalized opposition, whereas the uprising of June 1924 would move him irreversibly to efforts of establishing an authoritarian regime without opposition which he made become a reality after coming back to power in December of the same year. Still, the essence of this comeback and of the regime he established was the respect of legal and constitutional forms.